

VENDIM
Nr. 661, datë 21.9.2016

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 915, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, NGA KËSHILLAT E QARQEVE TE BASHKITË, TË RRJETIT TË RRUGËVE RURALE DHE TË ASETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË NDËRMARRJEVE TË MIRËMBAJTJES SË KËTYRE RRUGËVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 23, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe të neneve 3, shkronja “P”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit të njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rrjetit të rrugëve rurale, i cili është kaluar nga këshillat e qarqeve në administrimin e bashkive, në bazë të vendimit nr. 915, datë 11.11.2015, të Këshillit të Ministrave, pas rakordimit t'i shtohen disa segmente rrugore, sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ndryshimin e inventarit të rrugëve të transferuara në Bashkinë Librazhd dhe Bashkinë Përrenjas sipas tabelës 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Transferimi të kryhet nën mbikëqyrjen e prefektit të qarkut.

4. Ngarkohen bashkitë për të kryer evidentimin e inventarit të rrugëve rurale e komunale dhe, në bashkëpunim me Institutin e Transportit, të përditësojnë këtë rrjet rrugor në hartën digjitale duke iu referuar hartave bashkëlidhur këtij vendimi, brenda datës 31 dhjetor 2016. Harta digjitale e përditësuar publikohet në Gjeoportalin Kombëtar që administrohet nga ASIG-u.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti i Transportit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia për Zbatimin e Reformës Territoriale, prefektët e qarqeve, ASIG-u dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela 1


Nr.	Emërtimi i aksit rrugor	Kilometra (km)
	Bashkia Berat	15
1	Kthesa Velabisht – Starovë – Vetterrik	9
2	Kthesa Lapardha – Lapardha 2	6
	Bashkia Ura Vajguore	1.5
1	Rruga Ura Vajguore – Vetterrik	1.5
	Bashkia Kuçovë	6
1	Lapardha 2 – Lumas	6
		22.5
	Bashkia Elbasan	54
1	K/Labinot Fushë - Bizë	54
		54


Tabela 2

Nr.	Emërtimi i aksit rrugor	Kilometra (km)
	Bashkia Përrenjas	112,5
1.	Rr. nacionale – Bushticë	3
2.	Rr. nacionale – Qukës, Skënderbej	3
3.	Rr. nacionale /K. Pishkash–P. Veri/ Skroske	10
4.	Rr. nacionale/K. Pishkash–Min. Pishkash/ Lyqinje	7.5
5.	K/Qukës–Ura e Manastrecit/K. Katjel	21
6.	Ura e Manastrecit–Ura e Hakes	16
7.	Ura e Hakes–Qafë-Mali	10
8.	Rr. nacionale–Sutaj/Bardhaj	17
9.	Rr. nac./Pocivell–Kotodesh	4
10.	Golik–Homezh	21

Nr.	Emërtimi i aksit rrugor	Kilometra (km)
	Bashkia Librazhd	119
1.	Rr. nac./Ura Mirake–Gureshpat–Vilan	25
2.	Rr. nacionale–Dragostunje	7
3.	Rr. nac./ Librazhd–Babje/Dardhë	17
4.	K/Qarrishte–Qarrishte	28
5.	Rrapun–Kuturman	5
6.	Rr. nac./Hotolisht–Kokreve Verri/ Kokr. Katund	4
7.	K/Borove–Borove	4
8.	K/Zabzun–Zabzun	4
9.	K/Lunik–Lunik Fshat	4
10.	Qafë-Drize–Zdrajsh–Orenje	21








© 2016 Google
Image © 2016 DigitalGlobe

Imagery Date: 6/15/2015 34°T 409127.08 m E 4507518.18 m N elev: 179 ft eye alt: 11436 ft



© 2016 Google

Image © 2016 DigitalGlobe

Google earth

Imagery Date: 6/15/2015 34 T 411056.13 m E 4512518.25 m N elev 159 ft eye alt 9302 ft

